



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 115/4 prot.

Peshkopi, më 24.03.2021

VENDIM

Nr. 4 Date 24.03.2021

PËR
DHËNIEN E TITULLIT “NDERI I QARKUT DIBËR”
Z.MUHARREM MEHDI GJOKA

Mbështetur në, Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 82/1, gërma “b”, neni 77 gërma “ll” dhe “n”, në mbështetje Ligjit Nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Në zbatim të V.K.M Nr.861 datë 10.12.2014, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisioneve Këshillimore, për dhënien e medaljeve dhe titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e datës 24.03.2021, pasi shqyrtoj Vendimin e Kryesisë “ Për dhënien e titullit Nderi i Qarkut Dibër Z.Muharrem Mehdi Gjoka”, me 9 (nëntë) vota pro.

VENDOSI:

1. Z.Muharrem Mehdi Gjoka, t’i jepet Titulli “Nderi i Qarkut Dibër”
Me motivacionin; “ Për mbajtjen gjallë të vlerave etnokulturore, për kontributin e çmuar në mbështetjen dhe promovimin e vlerave të LANÇ dhe si ish-drejtuës në fushën e ndërtimeve dhe infrastrukturës rrugore në gjithë vendin” .
2. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Dibër dhe Sektori Juridik e Projekteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. U shpall sot, datë 24.03.2021.

KRYETAR

Valentina Haliti